



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.238/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazic dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelet e Sasha Marinkovic nga Komuna e Klllokotit, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të manipulimit me listat e votuesve, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hidhen si të pas afatshme apelet të identifikuar me numrat: ZL.A.nr.238/2017, ZL.A.nr.239/2017, ZL.A.nr.240/2017, ZL.A.nr.241/2017, ZL.A.nr.242/2017, ZL.A.nr.243/2017, ZL.A.nr.244/2017, ZL.A.nr.245/2017, ZL.A.nr.246/2017, ZL.A.nr.247/2017, ZL.A.nr.248/2017, ZL.A.nr.249/2017, të datës 18.10.2017 e Sasha Marinkovic, anëtarit të subjektit politik Narodno Jedinstvo nga Komuna e Klllokotit, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të manipulimit me listat e votuesve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar 12 apele me datë 18.10.2017 nga Sasha Marinkovic, anëtar i subjektit politik Narodno Jedinstvo, nga Komuna e Klllokotit, në emër të: Popovic Slavko, Dejan Rajkovic, Bozidar Rakic, Vlastimir Urosevic, Lepasava Urosevic, Krana Markovic, Milutin Milosevic, Stojanka Marinkovic, Vukic Velibor, Kojic Sanja, Nada Kojic dhe Predrag Kojic të gjithë nga Komuna e Klllokotit, pretendon se në faqen zyrtare të KQZ-së kanë parë se kanë votuar përmes postes, dhe që gjenden në listën e votuesve jashtë Kosovës. Personat e cekur më lartë deklarojnë nën përgjegjësinë e plotë materiale dhe penale, se nuk kanë votuar përmes postës dhe se nuk kanë dërguar fare kërkesën në KQZ, për votim përmes postes për votuesit nga jashtë Kosovës. Më tej kanë kërkuar që t'iu mundësohet e drejta e votës në Kosovë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel, të cilat i evidenton me shenjën ZL.Anr.238/2017, për shkak të ekonomizimit të procedurës, dhe kanë të bëjnë me çështje të njëjta.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apeleve, gjeti se:

Apelet janë të pas afatshme.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apeleve, ka gjetur se apelet e parashtruara nga Sasha Marinkovic, anëtarë i subjektit politik Narodno Jedinstvo, kundër KQZ-së, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 të LZP-së, ku përcaktohet: “*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve*”. Ngase prej shkresave të lëndës del se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, është realizuar nga data 26.07.2017 dhe ka përfunduar me datën 23.08.2017. Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 22.09.2017, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit. Apelet në PZAP nga Sasha Marinkoviq, janë paraqitur me datë 18.10.2017, çka do të thotë se apelet janë parashtruar pas afatit të përcaktuar në dispozitën Ligjore të nenit 122 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të nenit 115.1, dhe nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 238/2017 me datën 20.10.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.